



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF
KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kuvendi i Komunës së Gjakovës

01 Nr. _____ /2019

Datë: 04.03.2019

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 12 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, nenin 11 të Ligjit nr. 04/I-144 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale, nenin 21 të Rregullores së QKR-së nr. 23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale, në mbledhjen e mbajtur me datë 04.03.2019, pas diskutimit lidhur me pikën e 4-të, të rendit të ditës: Propozim vendim për këmbim të pronës komunale në ngastrën kadastrale me numër 1190-0 ZK Gjakovë, e miratoi këtë:

V E N D I M

Për këmbimin e pronës komunale

1. Kuvendi i Komunës së Gjakovës miraton vendimin për Këmbimin e pronës Komunale, me pronën e personit Juridik N.P. H.A.B - INIXHINIERING me seli një Gjakovë.
2. Parcela me numër 1190-0/Zk Gjakovë Qytet. me sipërfaqe totale prej 451m², është në bashkëpronësi me pjesën Ideale P.S.H. Kuvendi i Komunës së Gjakovës $\frac{1}{2}$ dhe personin Juridik N.P. H.A.B - INIXHINIERING me seli një Gjakovë $\frac{1}{2}$.
3. Këmbimi i pronës Komunale me sipërfaqe prej 225.5m² bëhet me qëllim që në vlerën e kësaj Pronë, Komuna të marrë në pronësi banesë sipas vlerës së Këmbimit për m² që do të dedikohet për banim Social.
4. Këmbimi do të bëhet sipas vlerës së caktuar nga Komisioni përgjegjës për vlerësimin e pronës dhe vlera do të llogaritet sipas çmimit të tregut për m² dhe do të dedikohen për banim Social.
5. Obligohen Organet e Administratës Komunale që t'i zbatojnë procedurat ligjore për Këmbimin e pronës komunale sipas pikës 2 të këtij vendimi konform Rregullores së QKR-së nr. 23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale.
6. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.
7. **Vendimi iu dërgohet:**
 - Kryetarit të Komunës, z. Ardian Gjini
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
 - Drejtori së për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë
 - Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
 - Shërbimit Profesional të Kuvendit të Komunës
 - Arkivit

